

05.05.2026

**Procesverbal - Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i procedurës:** “Sherbim Autobotesh”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Sherbim per furnizim me uje 65130000-3

**Vlera e fondit limit:** 19.820.000 (nentembehjete milion e teteqind e njezet mije) leke pa tvsh

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte **206.889,35** (dyqind e gjashte milion e teteqind e tetedhjetë e nente mije presje tridhjetë e pese) euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 05.05.2026 është 95.80.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 ;përkatësisht në 396.400 (treqind e nentëdhjetë e gjashtë mije e katerqind )leke*

Shuma e kerkuar e sigurimit te ofertes ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 4.137,78 (kater mije e njeqind e tridhjetë e shtate presje shtatedhjetë e tete) euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 05.05.2026 është 95.80 euro.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2 Kapaciteti ekonomik-financiar**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006) “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).

*Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2026 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet të kryera gjatë tri viteve të fundit (përlllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

**2.3.2** Një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjetë) personave për 3 muajt e fundit.

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar minimumi 5 (pesë) shofer si dhe minimumi 5 (pesë) punonjës të kualifikuar dhe të paisur me Dëshmi Kualifikimi për Sigurimin Teknik.
- b) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për 3 muajt e fundit.
- c) Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit.

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, lejet e drejtimit përkatëse Certifikatë të Aftësisë Profesionale (CAP), Dëshmi Kualifikimi për Sigurimin Teknik të lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit, kjo për rastin kur operatori ekonomik i ka pronësi mjetet.

Për rastin kur mjetet sigurohen nëpërmjet kontratës së qerasë atëhere autoriteti kontraktor për punonjësit (shoferë) mund të paraqesi kontratë punësimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** OE duhet të mbanë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lësuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni,  
 //////////////////////////////////////  
 //////////////////////////////////////  
 //////////////////////////////////////  
 //////////////////////////////////////  
 ////////////////////////////////////// në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor

**i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

## **Argumentim teknik për kërkesën e punonjësve**

Kërkesa për një **punësim mesatar prej të paktën 10 punonjësish gjatë 3 muajve të fundit** është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik:ka **kapacitete reale njerëzore** për të përballuar kontratën; siguron **shërbim të pandërprerë dhe në kohë**; përmbush standardet e **sigurisë teknike dhe operacionale**.

**Shoferët (minimumi 5):**Shërbimi i autoboteve është i lidhur drejtpërdrejt me **transportin e ujit**, që kërkon: drejtim të mjeteve të rënda; shpërndarje në disa zona njëkohësisht; Numri minimal garanton: **mbulim të turneve** (sidomos në raste emergjence); **zëvendësim në raste mungesash**; përmbushje të volumit të kërkuar të shërbimit.

## **2. Punonjës të kualifikuar me Dëshmi për Sigurimin Teknik (minimumi 5):**

- Autobotet përbëjnë **mjete teknologjike që kërkojnë kontroll dhe mirëmbajtje**;
- Këta punonjës janë të domosdoshëm për:
  - **kontrollin teknik të mjeteve** para dhe gjatë operimit;
  - **parandalimin e defekteve dhe aksidenteve**;
  - respektimin e kërkesave ligjore për **sigurinë teknike**;
- Dëshmia e kualifikimit garanton që personeli ka **aftësi të certifikuara**.

Këto kërkesa janë në përpjesëtim me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimit dhe synojnë të garantojnë realizimin me cilësi dhe në kohë të ndërhyrjeve në rrjetin e kanalizimeve.

**2.3.3 Dëshmi për autobotet, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.**

- **(5) Autobote uji.**

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: a) leje qarkullimi; b) çertifikate e kontrollit teknik; c) siguracion mjeti, (i vlefshëm);
- b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, ç) siguracion mjeti (i vlefshëm).
- c) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor. Në rastet kur pajisjet janë të inkuorpuara në mjete, dokumentacioni i kërkuar në këtë pikë nuk është i nevojshem, mjafton vetem dorëzimi i fotove të qarte të pajisjeve.
- d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklarohet se disponon mjetet për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

**Sqarim: 5 (pesë) mjetet të llojit AutoBot Uji duhet të jenë në gjendje efektive pune. Në pronësi ose me një kontratë qiramarrje të noterizuar për një periudhë jo më pak se 6 muaj.**

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

## **Argumentim teknik**

Kërkesa për minimumi **5 autobote uji** është vendosur për të garantuar:

- **Kapacitet operacional të mjaftueshëm** për përballimin e volumit të shpërndarjes së ujit në disa zona njëkohësisht;
- **Vazhdimësinë e shërbimit**, duke mundësuar zëvendësimin e menjëhershëm të mjeteve në rast defekti apo mirëmbajtjeje;
- **Menaxhimin e situatave emergjente**, ku kërkohet shpërndarje e shpejtë dhe në shkallë të gjerë;
- **Respektimin e grafikut të furnizimit**, pa krijuar vonesa apo ndërprerje të shërbimit ndaj qytetarëve.

Ky numër është përcaktuar në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës dhe përfaqëson një nivel minimal të nevojshëm për të siguruar një shërbim efikas dhe të qëndrueshëm.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalent (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
- b) Çertifikatën ISO 14001-2015 **ose ekuivalent** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin

certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

*ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*

*14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. ISO 14001:2015 është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë. ISO 14001:2015 ndihmon një organizatë të arrijë rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, të cilat ofrojnë vlerë për mjedisin, vetë organizatën dhe palët e interesuara.*

*ISO 14001:2015 është i zbatueshëm për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra, dhe zbatohet për aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj që organizata përcakton se mund t'i kontrollojë ose ndikojë duke marrë parasysh perspektivën e ciklit jetësor.*

### ***Argumentim i specifikimeve teknike për autobotet***

Specifikimet teknike të përcaktuara për autobotet janë hartuar në funksion të garantimit të një **shërbimi efikas, të sigurt dhe të pandërprerë për furnizimin me ujë**, duke reflektuar natyrën operacionale të kontratës dhe kushtet reale të terrenit.

Përcaktimi i kapaciteteve të ndryshme të autoboteve (nga **5000 L deri në 13000 L**, brenda intervalit të lejuar 4000 L – 14000 L) synon të sigurojë **fleksibilitet operacional**, duke mundësuar përdorimin e mjeteve të përshtatshme sipas zonave të shërbimit, përfshirë zona me akses të kufizuar dhe zona me kërkesë të lartë për ujë. Ndarja sipas numrit të “rrugëve” është bërë në përputhje me volumin e furnizimit dhe planifikimin e shpërndarjes, për të garantuar përmbushjen e nevojave pa vonesa.

Kërkesa për minimumi **5 autobote funksionale** është vendosur për të garantuar një **kapacitet minimal operativ**, mundësi për operim paralel në disa zona, si dhe **rezervë teknike** në rast defektsh apo mirëmbajtjeje, duke siguruar kështu vazhdimësinë e shërbimit.

Autobotet kërkohen të jenë të pajisura me **pompë presioni dhe sistem shkarkimi me vetërrjedhje**, në mënyrë që të sigurohet furnizim efikas si në kushte që kërkojnë presion (p.sh. depozita apo ndërtesa), ashtu edhe në kushte ku mund të shfrytëzohet graviteti për shkarkim më të shpejtë. Po ashtu, kërkesa për jo më pak se **2 dalje funksionale të pavarura** garanton furnizim simultan në disa pika dhe rrit sigurinë operacionale në rast defekti të njëjës dalje.

Kërkesa që autobotet të jenë në **gjendje të mirë teknike dhe funksionale** është thelbësore për garantimin e sigurisë dhe shmangien e ndërprerjeve të shërbimit, ndërsa përshtatshmëria për furnizim si nga **hidrantët e rrjetit**, ashtu edhe nga pjesa e sipërme në stacionet e pompimit, siguron fleksibilitet në burimet e furnizimit dhe shmang kufizimet teknike gjatë operimit.

Gjithashtu, pajisja me **tub shkarkimi me gjatësi jo më të vogël se 60 metra linear** është e domosdoshme për të mundësuar furnizimin në zona ku mjeti nuk mund të afrohet fizikisht (rrugë të ngushta, terrene të vështira), duke rritur ndjeshëm efikasitetin dhe sigurinë në terren.

Këto specifikime teknike janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë vendosur për të garantuar **cilësi, siguri dhe vazhdimësi të shërbimit**, në përputhje me parimin e **proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit**, duke mos krijuar barriera të panevojshme për konkurrencën, por duke siguruar që operatorët ekonomikë disponojnë kapacitetet reale për realizimin e kontratës.

**Njësia e prokurimit**